



Në mbështetje të nenit 12, 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 e datës 04 qershor 2008, nenit 14 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.10 e datës 03 prill 2019, nenit 6 paragrafi 3, dhe nenit 8 të Rregullores QRK Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ,nenit 9, 17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26 shtator 2008, duke u bazuar edhe në Shkresën përcjellëse të MPL-së Nr.020-389/5 të datës 31.12.2020, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 19. 01. 2021, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

#### VENDIM

### PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

#### Neni 1

Me këtë Vendim u ipen në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik paluejtshmëritë-lokalet afariste në pronësi të komunës, të cilat gjenden në qytetin e Lipjanit - Zona kadastrale në Lipjan, me shënimet si në tabelën në vijim:

Nr	Njësia kadastrale	Adresa	Kati	Numri i lokalit	Sipërfaqja në m <sup>2</sup>
1	0-71409044-01926-0-29-1-17-0	Rruga "Lidhja e Prizrenit" 29P+5 1 17	Bodrum	6	89.46m <sup>2</sup>
2	0-7140944-0024-5-14-0	Rruga "Lidhja e Prizrenit" 24 P 513	Përdhesë	15	159 m <sup>2</sup>
3.	0-7140944-0024-5-B1-0	Rruga "Lidhja e Prizrenit" 24 B 5I	Bodrum		239 m <sup>2</sup>

#### Neni 2

Pronat e paluajtshme –lokalet të cekura në pjesën tabelare në nenin 1 të këtij Vendimi ipen në shfrytëzim, afatshkurtër në afat prej 10 vitesh nëpërmjet procedurave të ankandit publik të përcaktuar me dispozitat e të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe të Rregullores QRK Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 3

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme-lokaleve në pronësi të Komunës të cekura më lartë bëhet me qëllim të realizimit të interesit publik përkatësisht krijimin e të hyrave vetanake dhe rritjen e vlerës së pronës publike komunale me destinim për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme të biznesit .

Neni 4

Procedurën e ankandit publik e zbaton Komisioni Vlerësues në pajtim me dispozitat e Rregullores QRK Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës .

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit-sektori pronëso-ri-juridik, Drejtorati për Ekonomi e Zhvillim dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Neni 7

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi

1. Shfuqizohet Vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës 15Nr.463-20393 i datës 29.03.2019,
2. Te Vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës 15Nr.463-28074 i datës 02.05.2018 në nenin 1 hiqet-fshihet lokali në numrin rendor 3 ,
3. Te Vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës 15Nr.463-6525 i datës 01.02.2018 në nenin 1 -fshihet paragrafi 1.3.
4. Anulohet Vendimi paraprak 15Nr.463-60371 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme i miratuar me datë 14.12.2020

15Nr. 463 - 4316

Lipjan, më 19. 01. 2021

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

